



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Plani Strategjik

2015-2019





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Plani Strategjik 2015-2019

*Miratur më 9 shtator 2014
Reviduar më 18 qershor 2015*

PËRMBAJTJA

<i>FJALA HYRËSE E GUVERNATORIT</i>	5
MANDATI.....	7
MISIONI	8
VIZIONI	8
VLERAT.....	8
QËLLIMET STRATEGJIKE.....	9
QËLLIMI STRATEGJIK 1	10
QËLLIMI STRATEGJIK 2	12
QËLLIMI STRATEGJIK 3	14
QËLLIMI STRATEGJIK 4	16
QËLLIMI STRATEGJIK 5	19
QËLLIMI STRATEGJIK 6	21

FJALA HYRËSE E GUVERNATORIT

Plani strategjik 2015 - 2019 paraqet mandatin, misionin, vizionin dhe vlerat e BQK-së dhe përcakton qëllimet strategjike të BQK-së për periudhën 2015 - 2019. Plani strategjik është baza kyçe për angazhimet madhore zhvillimore të BQK-së, duke siguruar një instrument të rëndësishëm të punës si për organet vendimmarrëse ashtu edhe për personelin e BQK-së. Në të një mënyrë të qartë janë të identifikuar aspektet e veprimtarisë së BQK-së, që synohen të zhvillohen në mënyrë domethënëse bashkë me avancimet përkatëse që synohen të arrihen. Janë adresuar sfidat aktuale si dhe ato të pritshme në drejtim të konsolidimit dhe ngritjes së aspekteve ligjore, organizative dhe të resurseve të BQK-së për ushtrimin efektiv dhe efikas të detyrave të saj dhe arritjen e suksesshme të objektivave të saj.

Mbështetur në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër relevant, veprimtaria e BQK-së përqendrohet rreth sistemit financiar dhe ekonomisë së vendit. Plani strategjik 2015 – 2019 ngërthen angazhimet zhvillimore në veprimtarinë e BQK-së të ndara sipas fushave të veçanta. Zhvillimi i mbikëqyrjes së institucioneve financiare që ushtrohet nga BQK-ja dhe i operimit të infrastrukturës financiare që sigurohet nga BQK-ja zë vend qendror në planin strategjik. Po ashtu pozita me rëndësi në planin strategjik zënë edhe avancimi i statistikave dhe kërkimeve të sistemit financiar dhe ekonomisë, si dhe nxitja e zhvillimit të gjithmbarshëm të sistemit financiar dhe mbështetja e politikave të përgjithshme ekonomike. Plani strategjik merr në konsideratë të plotë edhe aspiratat nacionale të integritimit evropian dhe bashkëpunimit ndërkombëtar sa i përket kompetencave të BQK-së. Në veçanti, orientimi i BQK-së drejt Sistemit Evropian të Bankave Qendrore është i reflektuar në mënyrë të theksuar në kuadër të qëllimeve strategjike. Plani strategjik 2015 – 2019 përfshin edhe zhvillime të brendshme organizative dhe administrative të BQK-së.

E tërë përmbajtja e Planit strategjik 2015 – 2019 është e shtjelluar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe e paraqitur në mënyrë të qartë. Në përgatitjen e Planit strategjik 2015 – 2019 kanë qenë të përfshirë anëtarë të personelit të të gjitha niveleve. Anëtarët e personelit të BQK-së janë në qendër të përpjekjeve për arritjen e qëllimeve strategjike për periudhën 2015 – 2019, qëllime të cilat, duke qenë ambicioze dhe me sfida, do të kërkojnë një angazhim të lartë brenda BQK-së si dhe një bashkëpunim me të gjithë akterët relevantë në vend dhe më gjerë.

Bedri Hamza

Guvernator

MANDATI

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik publik me kompetencë të plotë bazuar në Kushtetutë dhe ligjin përkatës. BQK-ja është institucioni kyç pjesëmarrës dhe rregullativ në sistemin financiar të Republikës së Kosovës dhe ka pavarësi dhe autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese.

Objektivi parësor i BQK-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Objektivi shtesë i BQK-së, i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore. Po ashtu, pa paragjykuar arritjen e këtyre objektivave, BQK-ja mbështet politikatat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë. BQK-ja vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.

Detyrat e BQK-së në arritjen e objektivave të përcaktuara përfshijnë:

- përcaktimin dhe zbatimin e politikave të një sistemi financiar stabil duke përfshirë mbikëqyrjen e një skeme të sigurimit të depozitave, kryerjen e operacioneve të tregut, si dhe ofrimin e likuiditetit emergjent;
- rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare;
- promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë;
- sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Kosovë;
- mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave ndërkombëtare;
- mbledhjen dhe publikimin e statistikave;
- kontribuimin në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore;
- informimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe publikut të gjerë rreth politikave, detyrave dhe operacioneve të saj;
- veprimin si bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë dhe çdo organ publik dhe organizatë publike të Kosovës;
- bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në këshillat dhe organizatat ndërkombëtare përkitazi me çështje brenda fushës së saj të kompetencave; dhe
- realizimin e çdo aktiviteti ndihmës që rrjedh nga ushtrimi i detyrave të saj.

Veprimtaria e BQK-së sigurohet nga organet e saj vendimmarrëse dhe personeli i saj. Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori. Bordi i Bankës Qendrore përbëhet nga kryetari dhe tre anëtarë të tjerë joekzekutivë si dhe nga Guvernatori dhe është i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve, si dhe mbikëqyrjen e administrimit dhe ushtrimit të operacioneve të BQK-së. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët dhe është i ngarkuar me zbatimin e vendimeve të BQK-së, si dhe administrimin dhe ushtrimin e operacioneve të saj. Guvernatori shërben si kryeshef ekzekutiv i BQK-së i ngarkuar me aktivitetet e përditshme të BQK-së, në realizimin e të cilave ndihmohet nga zëvendësguvernatorët. Personeli i BQK-së është i strukturuar në njësi organizative të përcaktuara në bazë të veprimtarive të veçanta operacionale dhe administrative.

MISIONI

Misioni ynë është të sigurojmë stabilitet financiar dhe monetar, të ofrojmë sistem efektiv të pagesave dhe furnizim adekuat me para të gatshme dhe të mbështesim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Republikën e Kosovës.

VIZIONI

Vizioni ynë është të jemi në mesin e bankave qendrore më efikase dhe efektive, si dhe të jemi institucion meritator në arritjen e integritimit evropian dhe afirmimit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

VLERAT

Vlerat tona pasqyrohen në të gjitha veprimtaritë e veçanta të BQK-së. Këto vlera janë të mishëruara në qëndrimin dhe punën e personelit dhe janë udhërrëfyese në caktimin e prioriteteve, marrjen e vendimeve, përmbushjen e detyrave, ndërtimin e marrëdhënieve me jashtë dhe kultivimin e raporteve ndërpersonale në BQK. Vlerat tona janë:

- **Promovimi i interesit publik** - Punojmë në të mirë të vendit dhe qytetarëve të tij.
- **Transparenca dhe llogaridhënia** - Sigurojmë transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha veprimtaritë tona.
- **Integriteti dhe etika** - Përmbushim me integritetin dhe etikën më të lartë të gjitha detyrat tona.
- **Cilësia dhe përkushtimi** - Mbajmë një kulturë të angazhimit individual dhe ekipor për kryerjen cilësore dhe me kohë të detyrave tona.
- **Zhvillimi i personelit** - Mbështesim zhvillimin e vazhdueshëm profesional të të gjithë personelit tonë.

QËLLIMET STRATEGJIKE

Në përputhje me misionin dhe vizionin tonë, ne kemi identifikuar dhe parashtruar gjashtë qëllime strategjike, të cilat më së miri pasqyrojnë synimet tona ndaj ekonomisë dhe shoqërisë kosovare. Qëllimet tona strategjike do të na mundësojnë të sigurojmë dhe të promovojmë stabilitetin financiar dhe t'i kontribuojmë zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Qëllimet tona strategjike janë:

- 1. Zhvillimi i funksioneve mbikëqyrëse në pajtim me praktikën dhe standardet bashkëkohore;**
- 2. Pasurimi i aktiviteteve kërkimore dhe statistikore lidhur me gjendjen dhe zhvillimin e ekonomisë dhe sistemit financiar;**
- 3. Zhvillimi i sistemeve bashkëkohore ndërbankare në Republikën e Kosovës;**
- 4. Nxitja e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës;**
- 5. Kontribuimi në proceset për integrim në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunim me institucionet e tjera ndërkombëtare;**
- 6. Zhvillimi i funksioneve të brendshme dhe përmirësimi i mjediseve të punës në BQK.**

QËLLIMI STRATEGJIK 1

Zhvillimi i funksioneve mbikëqyrëse në pajtim me praktikat dhe standardet bashkëkohore

BQK-ja kontribuon në stabilitetin e sistemit financiar përmes mbikëqyrjes së bankave komerciale, institucioneve të sigurimit, fondeve pensionale dhe institucioneve të tjera financiare. Autoriteti i BQK-së lidhur me mbikëqyrjen financiare është i përcaktuar me Ligjin për BQK-në dhe ligje të tjera të veçanta. BQK-ja e realizon mbikëqyrjen financiare si përmes aktiviteteve mbikëqyrëse në vend dhe nga jashtë të institucioneve financiare ashtu edhe përmes rregullimit, licencimit dhe regjistrimit të institucioneve financiare.

BQK-ja synon zhvillimin e funksioneve mbikëqyrëse në drejtim të harmonizimit me praktikën dhe standardet përkatëse në vendet e Bashkimit Evropian, duke kryer këto veprime strategjike:

1. Avancimi i mëtejshëm i infrastrukturës juridike:

- a. Inicimi dhe kontribuimi në rishikimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankat;
- b. Kontribuimi në përgatitjen e Ligjit për Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare;
- c. Rishikimi dhe plotësimi i rregulloreve të mbikëqyrjes së bankave, institucioneve mikrofinanciare, dhe institucioneve financiare jobankare;
- d. Hartimi i manualeve dhe procedurave për ushtrimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik të bankave dhe institucioneve mikrofinanciare;
- e. Hartimi i manualit për licencim të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare;
- f. Rishikimi dhe plotësimi i procedurës së trajtimit të aplikacioneve për licencim;
- g. Rishikimi dhe plotësimi i procedurës së trajtimit të ankesave;
- h. Kontribuimi në rishikimin dhe plotësimin e Ligjit për Sigurimet;
- i. Rishikimi dhe plotësimi i rregulloreve dhe udhëzimeve të mbikëqyrjes së institucioneve të sigurimit;
- j. Inicimi dhe kontribuimi në rishikimin dhe plotësimin e Ligjit për Fondet Pensionale;
- k. Rishikimi dhe plotësimi i rregulloreve të fondeve pensionale;
- l. Hartimi i manualit për mbikëqyrje të fondeve pensionale;
- m. Kontribuimi në përgatitjen e Ligjit për Letrat me Vlerë;
- n. Hartimi i rregulloreve të mbikëqyrjes së tregut të letrave me vlerë;
- o. Hartimi i manualit të mbikëqyrjes së tregut të letrave me vlerë;
- p. Hartimi i rregulloreve të mbrojtjes së shfrytëzuesve të shërbimeve financiare;
- q. Inicimi dhe kontribuimi në rishikimin dhe plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
- r. Hartimi i Rregullores për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- s. Hartimi i Manualit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Fuqizimi i funksionit të mbikëqyrjes financiare:

- a. Zhvillimi, forcimi dhe specializimi i kapaciteteve njerëzore e institucionale;
- b. Implementimi i kornizës së re raportuese;
- c. Forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit me institucionet financiare relevante;
- d. Publikimi i raporteve periodike mbi aktivitetet e mbikëqyrjes financiare;
- e. Ngritja e mëtejme e cilësisë së raportimit financiar;
- f. Përcjellja më e afërt e zhvillimeve në sektorin bankar, mikrofinanciar dhe jobankar me fokus të veçantë në institucionet sistemike përmes zhvillimit të modelit stres-test;
- g. Avancimi i mëtutjeshëm i sistemit të paralajmërimit të hershëm në nivel institucioni;
- h. Avancimi i vlerësimit të aspekteve të veçanta në kuadër të sektorëve financiarë;
- i. Avancimi i vlerësimit sektorial të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- j. Avancimi i bashkëpunimit mes njërive organizative përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe mbikëqyrje bankare.
- k. Forcimi i bashkërendimit të mbikëqyrjes financiare me njësitë relevante brenda BQK-së

3. Përafrimi me standardet ndërkombëtare:

- a. Vlerësimi i qasjes së mbikëqyrjes që do të mbështet implementimin e Kornizës së Bazelit dhe praktikave më të mira të vendeve të tjera;
- b. Aplikimi i plotë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në fushën e provizioneve kreditore;
- c. Avancimi i legjislacionit bankar mbi qeverisjen korporative dhe politikat e kompensimit;
- d. Avancimi i rregullativës bankare mbi kërkesat për kapital;
- e. Avancimi i rregullativës bankare mbi kërkesat për likuiditet;
- f. Avancimi i rregullativës bankare mbi procesin e rishikimit mbikëqyrës;
- g. Arritja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me autoritetet e huaja të mbikëqyrjes bankare;
- h. Arritja e pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të sigurimeve;
- i. Liberalizimi i tarifave të sigurimit të detyrueshëm;
- j. Rritja e transparencës;
- k. Vlerësimi i aktivizimit të kontratës së anuitetit lidhur me kursimet individuale pensionale;
- l. Zbatimi i parimeve bazë të BE-së dhe të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve për investimin e fondeve pensionale;
- m. Vlerësimi i liberalizimit të tregut pensional, përkatësisht shtylla e dytë apo kursimet individuale pensionale të detyrueshme.

4. Adresimi metodologjik i sfidave lidhur me institucionet financiare në vështirësi:

- a. Zhvillimi i metodologjive specifike lidhur me parandalimin dhe adresimin e sfidave të institucioneve me performancë jo të kënaqshme.

QËLLIMI STRATEGJIK 2

Pasurimi i aktiviteteve statistikore dhe kërkimore lidhur me gjendjen dhe zhvillimin e ekonomisë dhe sistemit financiar

Në funksion të kontribimit në stabilitetin financiar dhe monetar të vendit dhe të mbështetjes së politikave ekonomike të Qeverisë, BQK-ja përgatit statistika, analiza dhe kërkime ekonomike të destinuara për informimin e autoriteteve përgjegjëse, institucioneve relevante dhe publikut të gjerë. BQK-ja në mënyrë aktive fokusohet në përpilimin dhe publikimin e statistikave relevante. Analizat dhe kërkimet e BQK-së ofrojnë një pasqyrë të besueshme dhe me kohë mbi gjendjen e ekonomisë. Vlerësimi i pavarur i ecurive ekonomike është njëri ndër aktivitetet më të rëndësishme për të arritur zhvillim ekonomik afatgjatë në Republikën e Kosovës.

BQK-ja do t'i pasurojë aktivitetet statistikore dhe kërkimore që kanë të bëjnë me ekonominë në përgjithësi dhe sistemin financiar në veçanti përmes këtyre veprimeve strategjike:

1. Avancimi i mëtutjeshëm gjithëpërfshirës i statistikave monetare dhe financiare (SMF) si dhe statistikave të sektorit të jashtëm (SMJ):

- a. Zhvillimi i përpilimit dhe publikimit të SMF dhe SSJ me standarde ndërkombëtare;
- b. Arritja e konvergencës dhe harmonizimit të plotë me legjislacionin dhe metodologjinë e BE-së dhe zhvillimi i raportimit të rregullt në Eurostat të SMF dhe SSJ;
- c. Zbatimi i standardeve të reja ndërkombëtare në fushën e statistikave;
- d. Rritja e vazhdueshme e mbulueshmërisë, frekuencës dhe shkurtimit të afatit të publikimit të SMF dhe SSJ;
- e. Zbatimi i aplikacioneve teknike moderne statistikore në kontekst të përpilimit dhe validimit më të avancuar të statistikave të publikuara;
- f. Ofrimi i ekspertizës në fushën e statistikave në funksion të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- g. Përpilimi i produkteve të reja statistikore;
- h. Rritja e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- i. Përpilimi i politikës së revidimeve të të dhënave statistikore.

2. Zhvillimi i mëtejshëm i funksionit të analizave dhe kërkimeve ekonomike:

- a. Avancimi i modelit makroekonomik për parashikimin e zhvillimeve makroekonomike dhe financiare në vend dhe publikimi në baza të rregullta i projeksioneve makroekonomike;
- b. Zgjerimi i bazës së indikatorëve të sektorit real dhe financiar për një vlerësim më adekuat të rreziqeve për stabilitetin financiar;
- c. Rritja e vëllimit të analizave kërkimore rreth zhvillimeve makroekonomike në vend;
- d. Rritja e numrit dhe frekuencës së publikimeve rreth zhvillimeve makroekonomike në vend, me fokus të veçantë në stabilitetin e çmimeve;

- e. Përforsimi i kooperimit me institucionet vendore dhe institucionet ndërkombëtare në vlerësimin e zhvillimeve ekonomike dhe financiare në koordinimin e aktiviteteve me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

3. Vlerësimi i stabilitetit financiar dhe identifikimi i rreziqeve sistematike:

- a. Caktimi i objektivave makroprudenciale në harmoni me kornizën e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik;
- b. Identifikimi dhe rangimi i instrumenteve makroprudenciale;
- c. Analiza e mungesave të të dhënave dhe adresimi i tyre;
- d. Avancimi i kornizës organizative për mbikëqyrje makroprudenciale;
- e. Avancimi i kornizës institucionale për mbikëqyrje makroprudenciale;
- f. Operacionalizimi i instrumenteve makroprudenciale sipas rregullativës së BE-së mbi kërkesat për kapital;
- g. Avancimi i stres-testit të sektorit bankar në drejtim të makro stres-testit dhe zhvillimi i stres-testit për sektorin e sigurimeve dhe të pensioneve;
- h. Avancimi i mëtejshëm i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm;
- i. Avancimi i mëtejshëm i Raportit të Stabilitetit Financiar, me fokus në shtimin e indikatorëve të sektorëve të veçantë dhe në përfshirjen më të madhe të pritjeve për zhvillimet e ardhshme, si dhe rritjen e frekuencës së publikimit të këtij raporti;
- j. Shtimi i numrit të publikimeve në fushën e zhvillimit dhe stabilitetit të sektorit financiar;
- k. Rritja e vëllimit të analizave kërkimore rreth zhvillimeve financiare në vend.

QËLLIMI STRATEGJIK 3

Zhvillimi i sistemeve ndërbankare bashkëkohore në Republikën e Kosovës

Për të siguruar sisteme të sigurt, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë në Republikën e Kosovës, BQK-ja operon Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar, i cili aktualisht është i vetmi sistem ndërbankar i transferimit të fondeve në vend dhe sistemin depozitar qendror bashkë me platformën elektronike për tregtim të letrave me vlerë të qeverisë. Në këtë drejtim, BQK-ja është e angazhuar edhe në sigurimin e operimit të një sistemi modern të shlyerjes individuale të pagesave në kohë reale. BQK-ja po ashtu operon Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare, i cili u shërben autoriteteve përgjegjëse për zbatim të ligjit dhe Regjistrin e Kredive të Kosovës, i cili është i vetmi sistem i ndarjes së informacionit kreditor mes bankave komerciale dhe institucioneve të tjera kredihënëse në vend. Pos operimit, BQK-ja kryen edhe aktivitete mbikëqyrëse lidhur me sistemet ndërbankare, posaçërisht lidhur me sistemet e pagesave.

BQK-ja do të zhvillojë sistemet ndërbankare bashkëkohore në vend, duke ndërmarrë këto veprime strategjike:

1. Sigurimi i sistemeve ndërbankare efikase dhe cilësore për transferim të fondeve dhe të letrave me vlerë, si dhe për raportim të poseduesve të llogarive bankare:

- a. Implementimi i një sistemi të transfereve të automatizuara (anglisht: Automated Transfer System - ATS), i cili do të përfaqësojë shtyllën kryesore të sistemit kombëtar të pagesave në Kosovë;
- b. Avancimi i mëtejshëm i sistemit depozitar qendror të letrave me vlerë (anglisht: Central Securities Depository - CSD) dhe platformës elektronike për tregtim (anglisht: Electronic Trading Platform – ETP) në funksion të zhvillimit të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dhe të emetimit të letrave afatgjata me vlerë të Qeverisë;
- c. Angazhimi në themelimin e një sistemi bashkëkohor të tregut ndërbankar të parasë, i cili do të shërbejë si një element i rëndësishëm për bankat komerciale për menaxhimin e likuiditetit;
- d. Avancimi teknologjik i Regjistrit të Poseduesve të Llogarive Bankare.

2. Zhvillimi i kornizës rregullative dhe kapaciteteve për mbikëqyrje të sistemeve të pagesave:

- a. Rishikimi dhe plotësimi i kornizës së mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave në pajtim me standardet evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- b. Avancimi i përgjithshëm i funksionit të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave në Kosovë;

- c. Avancimi i rregulloreve dhe metodologjisë së raportimit të instrumenteve dhe sistemit të pagesave, si dhe zhvillimi i një softueri për statistika të sistemit të pagesave.

3. Avancimi i funksionit të Regjistrimit të Kredive të Kosovës për të mbështetur aktorët relevantë për informacionin kreditor:

- a. Kontribuimi në avancimin e proceseve përkatëse të veprimtarive të BQK-së (mbikëqyrje bankare, mbikëqyrje e sigurimeve, analizat dhe statistikat);
- b. Studimi i mundësive të ndërtimit të ndërlidhjeve softuerike të bazave të të dhënave të industrisë raportuese në sistemin e Regjistrimit të Kredive të Kosovës me bazën e të dhënave të regjistrimit civil, bazën e të dhënave të regjistrimit të bizneseve dhe bazën e të dhënave të sistemit unik të adresave.

QËLLIMI STRATEGJIK 4

Nxitja e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës

BQK-ja angazhohet të promovojë zhvillimin e sistemit financiar në Republikën e Kosovës duke i ofruar qeverisë ekspertizë, si dhe duke siguruar një ambient që mbron iniciativat private të tregut. Pos që mbështet dhe mirëmban funksionimin e patrazuar të sistemit financiar duke ushtruar me përpikëri detyrat e saj parësore, BQK-ja promovon bashkëpunimin në Republikën e Kosovës me qëllim të krijimit dhe zhvillimit të solucioneve teknike efikase dhe të hapura si dhe standardeve të përbashkëta për sistemin financiar. BQK-ja konsideron veten si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit financiar në Republikën e Kosovës. Besueshmëria ndaj aktiviteteve të BQK-së në zhvillimin e sistemit financiar promovohet përmes komunikimit efektiv dhe të orientuar si duhet.

Për të nxitur zhvillimin e shëndoshë të sistemit financiar në vend, BQK-ja do të kryejë këto veprime strategjike:

1. Zgjerimi dhe thellimi i komunikimit me media dhe publikun e gjerë në funksion të promovimit të vlerave dhe veprimtarisë së BQK-së:

- a. Zhvillimi i qasjes dhe politikës së komunikimit me jashtë;
- b. Avancimi i mekanizmave të komunikimit të jashtëm për të gjitha palët e interesit, duke përfshirë këtu faqen e internetit të BQK-së, kumtesat zyrtare, publikimet mbi veprimtarinë e BQK-së, konferencat e rregullta për media, seminarët për çështjet ekonomike dhe financiare;
- c. Zhvillimi i mëtutjeshëm i funksionit të edukimit financiar, me qëllim të krijimit të kulturës së mirëfilltë financiare, që u ndihmon të gjitha palëve të interesit për të marrë vendime të duhura.

2. Promovimi i bashkëpunimit të përgjithshëm lidhur me mbikëqyrjen e institucioneve financiare:

- a. Thellimi i bashkëpunimit me institucionet mbikëqyrëse të huaja nëpërmjet:
 - ekzaminimeve të përbashkëta,
 - këmbimit të informacionit,
 - bashkërendimit të veprimtarive përmes pjesëmarrjes në kolegjet mbikëqyrëse;
- b. Avancimi i bashkëpunimit me institucionet relevante në Kosovë në fushën e raportimit financiar;
- c. Angazhimi në kuadër të institucioneve relevante për fuqizimin e kornizës për një sektor stabil dhe të shëndoshë financiar;
- d. Asistimi për Shoqatën e Sigurimeve lidhur me promovimin e produkteve tjera të sigurimeve;

- e. Mbështetja e Byrosë Kosovare të Sigurimeve për anëtarësim në Këshillin e Byrove të Kartanit të Gjëlber dhe për riorganizim të saj pas anëtarësimit.

3. Mbështetja e modernizimit të mëtejme të shërbimeve të pagesave dhe promovimi i bashkëpunimit mes akterëve të sistemit kombëtar të pagesave:

- a. Avancimi i rolit të BQK-së si katalizator për progres në lëmin e pagesave në Republikën e Kosovës;
- b. Implementimi në pagesa vendore i formatit ndërkombëtar të numrit të llogarisë bankare (anglisht: IBAN - International Bank Account Number);
- c. Analizimi dhe adresimi i hendekut mes kornizës kombëtare dhe akteve të BE-së mbi shërbimet e pagesave;
- d. Harmonizimi i kornizës kombëtare mbi institucionet e parasë elektronike në pajtim me aktet e BE-së;
- e. Analizimi dhe adresimi i hendekut mes kornizës kombëtare dhe akteve të BE-së mbi transferet kredituese dhe debitimin direkt në valutën euro;
- f. Harmonizimi i kornizës kombëtare mbi pagesat përmes internetit në pajtim me aktet e BE-së;
- g. Analizimi dhe adresimi i hendekut mes kornizës kombëtare dhe akteve të BE-së mbi statistikat e pagesave;
- h. Veprimi me një rol shtytës në implementimin e një sistemi kombëtar ndërbankar të kartave të pagesave (anglisht: Interbank Card Switch - ICS), për të ofruar funksionalitet ndëroperimi mes lëshuesve të kartave të pagesave;
- i. Zgjerimi i bashkëpunimit për avancim të mëtejme të shërbimeve të pagesave me akterët relevantë në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave.

4. Mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare në Republikën e Kosovës:

- a. Nxitja dhe mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare;
- b. Avancimi i bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse dhe akterët relevantë për zhvillimin e kushteve të nevojshme për tregjet financiare.

5. Avancimi i qarkullimit të parasë së gatshme në ekonomi:

- a. Intensifikimi i bashkëpunimit me autoritetet relevante dhe bankat lidhur me qarkullimin e parasë së gatshme;
- b. Rishikimi rregullativës ekzistuese për bankat mbi paranë në qarkullim;
- c. Ngritja e standardeve të procesimit të parasë së gatshme.

6. Rritja e transparencës dhe fuqizimi i mbrojtjes së konsumatorëve të shërbimeve financiare:

- a. Zgjerimi i aktiviteteve për vetëdijesimin e konsumatorëve të shërbimeve financiare për të drejtat e tyre;
- b. Krijimi i një hapësire të veçantë në faqen e internetit të BQK-së me informata të detajuara për parashtrimin e ankesave ndaj institucioneve financiare.

7. Promovimi i zhvillimit të konkurrencës dhe krijimit të një ambienti financiar transparent:

- a. Zgjerimi i përmbajtjes së publikimeve mbi sektorët financiarë për informim më të plotë të akterëve relevantë;
- b. Promovimi i tregut financiar për të tërhequr hyrjen e konkurrentëve të rinj.

QËLLIMI STRATEGJIK 5**Kontribuimi në proceset për integrim në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunim me institucionet e tjera ndërkombëtare**

BQK-ja promovon procese përmes të cilave Republika e Kosovës integrohet në Bashkimin Evropian dhe bëhet pjesë e institucioneve të tjera ndërkombëtare. BQK-ja ndërmerr hapa për të ngritur nivelin e njohurisë së publikut të gjerë duke përfshirë edhe atë ndërkombëtar mbi BQK-në dhe Republikën e Kosovës, përmes aktiviteteve të arsyeshme dhe publikimeve të rregullta mbi veprimtarinë e saj. Organet vendimmarrëse dhe personeli i BQK-së rregullisht marrin pjesë në ngjarje ndërkombëtare për të promovuar Republikën e Kosovës dhe BQK-në. BQK-ja ushtron dhe zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me standardet dhe përvojat ndërkombëtare dhe bashkëpunon me institucionet relevante ndërkombëtare. BQK-ja është plotësisht e vetëdijshme mbi përgjegjësinë e saj ndaj palëve vendore dhe ndërkombëtare të interesit për të ndihmuar në sjelljen e ekonomisë dhe sistemit financiar të Kosovës sa më afër atyre evropiane.

BQK-ja do të kontribuojë në integrimin në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimin me institucione të tjera ndërkombëtare përmes kryerjes së këtyre veprimeve strategjike:

1. Koordinimi me autoritetet përgjegjëse lidhur me komunikimin dhe bashkëpunimin me asociacione dhe organizata ndërkombëtare:

- a. Avancimi i pjesëmarrjes në asociacione dhe organizata ndërkombëtare;
- b. Përfaqësimi i përbashkët i Republikës së Kosovës, veçanërisht i sistemit të saj financiar.

2. Pjesëmarrja aktive në procesin e integritit evropian dhe bashkëpunimit ndërkombëtar:

- a. Zhvillimi i planit të brendshëm të veprimit për implementimin e çështjeve lidhur me funksionet e BQK-së të përfshira në Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit;
- b. Avancimi i koordinimit të përmbushjes së detyrimeve të BQK-së në nivel nacional që rrjedhin nga procesi i integritit evropian në përgjithësi;
- c. Ngritja e kapaciteteve brenda BQK-së për tejkalimin e sfidave të dala nga procesi i integritit evropian dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;
- d. Avancimi i bashkëpunimit të BQK-së me institucionet financiare evropiane dhe ndërkombëtare si dhe me bankat qendrore dhe autoritetet financiare evropiane.

3. Ristrukturimi dhe ngritja e veprimtarisë së BQK-së në fushën e integrimit evropian dhe marrëdhënieve ndërkombëtare:

- a. Themelimi i njësisë së integrimit evropian dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
- b. Centralizimi i komunikimeve dhe dokumentacionit lidhur me proceset e integrimit evropian;
- c. Zhvillimi i marrëdhënieve bilaterale me Komisionin Evropian, Bankën Qendrore Evropiane dhe bankat qendrore të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore;
- d. Zhvillimi strategjik i aftësive të personelit të BQK-së lidhur me integrimin evropian.

QËLLIMI STRATEGJIK 6

Zhvillimi i funksioneve të brendshme dhe përmirësimi i mjediseve të punës

BQK-ja i kushton rëndësi të lartë modernizimit të vazhdueshëm të proceseve dhe sistemeve të menaxhimit të resurseve të saj me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës. BQK-ja është e vendosur për zhvillimin e funksioneve të brendshme tipike për bankat qendrore bashkëkohore që funksionojnë në rrethana të ngjashme. Po ashtu BQK-ja është e përkushtuar për sigurimin e kushteve bashkëkohore të punës për të gjithë anëtarët e personelit të saj.

Për të zhvilluar funksionet e brendshme dhe përmirësuar mjediset e punës, BQK-ja do të ndërmarrë këto veprime strategjike:

1. Optimalizimi i investimeve të mjeteve financiare të menaxhuara nga BQK-ja:

- a. Bashkëpunimi me banka qendrore të Eurozonës si dhe me institucione financiare ndërkombëtare në avancimin e aktiviteteve operacionale dhe analitike të investimeve;
- b. Zgjerimi i gamës së investimeve me instrumente afatgjate të borxhit të emetuara apo garantuara nga
 - i. shtetet, bankat qendrore, institucionet tjera financiare me kapital të garantuar nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe
 - ii. institucionet financiare ndërkombëtare dhe multilaterale.

2. Ngritja e sistemeve dhe rregullave të menaxhimit financiar:

- a. Avancimi i sistemit të raportimit financiar dhe evidencës financiare;
- b. Avancimi i qasjes pro-qëndrueshmërisë financiare afatgjate të BQK-së;
- c. Avancimi i sistemit të kontrolleve të brendshme;
- d. Avancimi i procesit të përgatitjes dhe implementimit të buxhetit;
- e. Avancimi i modelit të kontabilitetit të shpenzimeve.

3. Zhvillimi i funksionit të menaxhimit të rrezikut në nivel të BQK-së:

- a. Zhvillimi i principeve dhe standardeve për menaxhim të rreziqeve;
- b. Zhvillimi i kornizës së menaxhimit të rreziqeve;
- c. Zhvillimi i metodologjisë së identifikimit, vlerësimit, monitorimit dhe kontrollit të rreziqeve;
- d. Integrimi i funksionit të menaxhimit të rreziqeve në të gjitha njësitë organizative.

4. Avancimi i praktikës së menaxhimit të burimeve njerëzore:

- a. Promovimi i kulturës organizative që reflekton përbushje të detyrave me përgjegjësi dhe cilësi të lartë;
- b. Avancimi i mëtutjeshëm i politikave, procedurave dhe sistemeve të burimeve njerëzore që mundësojnë zhvillim dhe menaxhim të duhur të personelit dhe proceseve të BQK-së;
- c. Funkcionalizimi i proceseve për zhvillimin profesional të të gjithë anëtarëve të personelit të BQK-së;
- d. Themelimi i pozitës së Ombudspersonit/Zyrtarit të Etikës me qëllim të trajtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me mirëqenien e personelit;
- e. Themelimi i qendrës së trajnimeve dhe sigurimi i qëndrueshmërisë operacionale dhe financiare të saj.

5. Fuqizimi i kornizës së brendshme rregullative të BQK-së në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare:

- a. Përgatitja e rregullës së brendshme për hartimin e politikave;
- b. Rishikimi dhe plotësimi i rregullave dhe politikave të brendshme mbi aspektet juridike të përgjithshme;
- c. Promovimi dhe shpërndarja e brendshme e politikave dhe rregullave të brendshme;
- d. Avancimi i praktikës së rishqyrtimit të vendimeve.

6. Ngritja e infrastrukturës dhe sistemeve të përgjithshme të teknologjisë së informacionit dhe avancimi i sigurisë së informacionit:

- a. Modernizimi teknik dhe organizativ i pajisjeve dhe rrjetave të teknologjisë së informacionit;
- b. Avancimi i menaxhimit të rrezikut të informacionit;
- c. Formalizimi i procedurave të menaxhimit të projekteve;
- d. Përmirësimi i menaxhimit të performancës së shërbimeve të teknologjisë së informacionit;
- e. Zhvillimi i kërkesave në nivel të shërbimeve të teknologjisë së informacionit;
- f. Standardizimi i proceseve të teknologjisë së informacionit për të arritur maturitetin dhe cilësinë e shërbimeve;
- g. Zhvillimi i menaxhimit të inventarit dhe konfigurimit të aseteve të teknologjisë së informacionit;
- h. Avancimi i sigurisë së infrastrukturës teknike;
- i. Avancimi i proceseve të monitorimit në funksion të përmirësimit të sigurisë së informacionit;
- j. Avancimi i procesit të zhvillimit të softuerëve me fokus në aspektet e sigurisë;

- k. Zhvillimi i kontrolleve të pajtueshmërisë dhe mbrojtjes;
- l. Përmirësimi i proceseve të menaxhimit të privilegjeve të përdoruesve të sistemeve;
- m. Zhvillimi i planifikimit të vazhdimësisë së funksionimit;
- n. Avancimi organizativ dhe funksional i Divizionit të sigurisë së informacionit;
- o. Implementimi i sistemit për statistika që ka për qëllim integrimin e raportimit të të gjitha institucioneve financiare në një sistem të vetëm;
- p. Zhvillimi i portalit të brendshëm për komunikim dhe bashkëpunim mes anëtarëve të personelit.

7. Modernizimi i praktikës së brendshme të trajtimit dhe arkivimit të informacionit:

- a. Përgatitja e kornizës së menaxhimit të informacionit, e cila do t'i përshkruajë qeverisjen e përgjithshme dhe përfitimet e menaxhimit adekuat të informacionit në nivel të institucionit;
- b. Përgatitja e strategjisë së menaxhimit të informacionit, e cila do të sigurojë përmbushjen e kërkesave të aplikueshme dhe përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të informacionit;
- c. Përkufizimi i roleve dhe përgjegjësisë të njësisë organizative dhe anëtarëve të personelit lidhur me menaxhimin e informacionit;
- d. Implementimi i një sistemi të menaxhimit të dokumenteve dhe shënimeve elektronike (anglisht: Electronic Document and Records Management System - EDRMS);
- e. Përgatitja e politikës për krijimin dhe ruajtjen elektronike të informacionit që ka të bëjë me ushtrimin e detyrave dhe mbështetjen e aktiviteteve bazuar në kërkesat ligjore, llogaridhënëse dhe afariste;
- f. Përgatitja e kornizës së metadatave lidhur me resurset e informacionit;
- g. Përgatitja e politikës për vlerësimin e informacionit për qëllime të arkivimit;
- h. Rishikimi i Listës së kategorive të dokumenteve sipas afateve të ruajtjes;
- i. Rishikimi i Rregullës së brendshme për fshehtësinë;
- j. Përgatitja e politikës për vendmbajtjen e dokumenteve;
- k. Përgatitja e politikës për ruajtjen e gjendjes së dokumenteve.

8. Avancimi i funksionimit të auditimit të brendshëm në pajtim me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare:

- a. Harmonizimi i Statutit të Auditimit të Brendshëm dhe Kodit të Mirësjelljes së Auditimit të Brendshëm me praktikat më të mira;
- b. Përgatitja e programit për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së auditimit të brendshëm;
- c. Zhvillimi i planit të veprimit për implementimin e aktiviteteve zhvillimore lidhur me auditimin e brendshëm;
- d. Përgatitja e një programi afatgjatë të trajnimit për personelin e auditimit të brendshëm;
- e. Kryerja e vlerësimit mujor të personelit si pjesë e programit për sigurimin dhe

- përmirësimin e cilësisë së auditimit të brendshëm;
- f. Rishikimi dhe plotësimi i Manualit të Auditimit të Brendshëm;
 - g. Adoptimi i një metodologjie të vlerësimit të rrezikut si bazë për planifikimin vjetor të punës së auditimit të brendshëm;
 - h. Zhvillimi i aktiviteteve të auditimit të brendshëm, duke përfshirë edhe funksionet e papërkufizuara institucionalisht që paraqesin vijën e dytë mbrojtëse;
 - i. Integrimi i auditimit të brendshëm të teknologjisë së informacionit në auditimin e brendshëm të përgjithshëm;
 - j. Forcimi i transparencës dhe konsistencës së dokumentacionit të auditimit të brendshëm.

9. Përmirësimi dhe zgjerimi i hapësirave të punës:

- a. Renovimi i zyrave të punës dhe mjediseve përcjellëse në ndërtesën e BQK-së;
- b. Përgatitja dhe funksionalizimi i një qendre bashkëkohore të vazhdimësisë së punës.



Rr. Garibaldi nr. 33
10000 Prishtina
Republika e Kosovës
www.bqk-kos.org